



Falsifikime në emër të Palit të bëra në Bibël

Description

Bart D. Ehrman

Fragment i shkëputur nga lib i Bart D. Ehrman-it me titull: "Forged" (Harper One, 2011), f. 79-115.

Kur në vitin 1971 u bëra i krishterë dhe anëtar i Kishës "Instituti jeta e re" (borne again) isha i etur të lexoja dhe mësoja gjithçka që mundesha rreth Shkrimeve të shenjta. Në atë kohë nuk ia kisha idenëse ekzistonte diçka e tillë si studimi akademik i Biblës (biblical scholarship), apo se ekzistonin libra të shkruar nga ekspertë të vërtetë të cilët njihnin në themel gjuhët e lashta – si p.sh. Greqishtja apo Hebraishtja – dhe kishin zbërthyer deri në fund, për vite me radhë, burimet e hershme në mënyrë që të ofronin rrëfime historikisht të sakta. Unë isha po aq i kënaqur me lajmin e mirë rreth Jezusit apo Palitsa edhe me diçka më serioze. Gjithsesi romanet ishin të lehta për tu lexuar dhe kjo ishte pikërisht ajo që unë pëlqoja.

Në vitin 1970 një nga novelat bestseller biblike më të mira të të gjitha kohërave sapo ishte publikuar. Vepra ishte shkruar nga Taylor Caldwell me titull "Great Lion of God", një rrëfim imagjinar i jetës së apostullit Pal. Për tetë muaj kjo vepër kishte qenë në listën e bestsellerave të revistës "New York Times" dhe për sa më përkiste mua nëse kjo vepër lexohej nga kaq shumë njerëz atëherë ajo duhej të ishte e saktë dhe informuese. Kështu që unë epërpiva atë në pak kohë. Vetëm më vonë e kuptova se sa shumë trillim kishte në këtë novelë "historike". Mbaj mend, vite më vonë, se shpresojafuqimisht që kjo novelë të mos më kishte larguar shumë nga "dija e përgjithshme" rreth Palit.

Një ngjarje e cila më ka gëluar në kokë përgjatë viteve përfshinte përpjekjen e Caldwell-it për të shpjeguar se përse Pali ishte kaq i prirur për t'ukonvertuar e për t'u bërë një ndjekës i Jezusit pasi kishte qenë një persekutues i dhunshëm i Kishës. Në vija të përgjithshme, mënyra se si ai shpalosi skenarin ishte pak a shumë kjo: Ndërsa ishte adoleshent, Pali ishte jashtëzakonisht i zellshëm në besimin e tij hebre dhe përpiquej fuqishëm që ti qëndronte besnik ligjit hebraik. Por në një moment ai u dha pas një tundimi të papërbalueshëm. Ky tundim konsistonte në takimin e fshehtë me një vajzë skllave flokëzeze në liqenin e vendit. Ky takim seksual krijoi një barrë të tmerrshme faji në djaloshin Pal, të cilën ai u përpoq ta zbuste dukeu bërë akoma më shumë fetar. Ndërsa ishte ende një djalosh, ai dëgjoi për ndjekësit e Jezusit të cilët po predikonin se shpëtimi mund të prekë edhe ata që nuk *ndjekin* Ligjin. Shpëtimi vjen thjesht përmes besimit në Krisht. Pali u zemërua dhe morri lejezyrtare për t'i kundërshtuar dhe persekutuar të krishterët. Kjo ishte një mënyrë e mëtejshme që ai përdori për të zgjidhur ndjenjën e tij personale të fajt; duke u angazhuar në zellin fetar ai qetëson tendërgjegjen etij. Por ai zbuloi se sa më shumë mendohej të ndiqte ligjin hebraik, në të gjitha detajet etij, aq më shumë ai pushtohej nga ndjesia e fajtse e kishte shkelur atë.

Atëherë, rrugës për Damask atij iu shfaq Jezusi në vegim. Për herë të parë në jetën e tij ai kuptoi se nuk mund të ndiqte dot ligjin në tërësinë e tij siedhe se nuk ishte aspak e nevojshme ta bënte këtë gjë. Jezusi solli një çlirim nga ndjenja e thellë dhe e fshehtë e fajt që flinte brenda tij dhe nëshenjë mirënjohjeje të thellë ai vendosi të njëjtin zell në të qenurin misionar për Kishën, në vend se persekutues i saj.

Libri i Caldwell-it ishte i detyrueshëm, veçanërisht për një adoleshent si unë që dëshironte të njihnte më shumë rreth të vërtetës së fesë që sapo kishazbuluar. Siç doli në pah, e tërë historia është një trillim. Nuk ka asnjë të dhënë historike për aventurën seksuale të Palit në liqenin e vogël të vendit ku jetonte dhe asnjë tregues se ai ndjehej tmerrësisht në faj për shkak se ishte i paafte të ndiqte urdhëresat e Ligjit, ndonëse shumë të krishterë vazhdojnë ta keqinterpretojnë Palin në këtë mënyrë. Ne kemi një

njohtë të arsyeshme të asaj që Pali mendonte, duke qenë se ai na ka lënë disa letra (të gjitha në Dnjatën e Re). Kur ai flet rreth jetës së tij si hebre përpara Jezusit, ndonëse nuk tregon se ishte jashtëzakonisht i zellshëm për Ligjin, ai e bën plotësisht të qartë se kjo nuk vinte si shkak i të ndjerit faktor si shkak i pamundësisë për ndjekur ligjin. Përkundrazi, Pali tregon se si hebre i vërtetë ai ishte

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi